



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 27, Datë 27.01.2025

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN PËR
SIGURINË KIBERNETIKE TË INFRASTRUKTURAVE KRITIKE NË SEKTORIN E
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 18 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; ligjit nr. 2/2017, “Për sigurinë kibernetike”; Vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 553, datë 15.07.2020 “Për miratimin e listës së infrastrukturës së informacionit kritik dhe të rëndësishëm”; Rregullores për sigurinë kibernetike të infrastrukturës kritike në sektorin e energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 126, datë 30.07.2020; neneve 15 dhe 26 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, i ndryshuar; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.01.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 307 prot., datë 24.01.2025, të Anëtarit të Bordit, Sekretarit të Përgjithshëm, Drejtorit të Drejtorisë Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve dhe Përgjegjësit të Sektorit të Sigurisë Kibernetike dhe IT-së “Mbi fillimin e procedurave për disa ndryshime në Rregulloren për sigurinë kibernetike të Infrastrukturave Kritike në Sektorin e Energjisë Elektrike”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 126, datë 30.07.2020, miratoi “Rregulloren për sigurinë kibernetike të infrastrukturës kritike në sektorin e energjisë elektrike”.
- Rregullorja u hartua me mbështetjen e National Association of Regulatory Utility Commissioners (NARUC), duke u bazuar në përcaktimet e legjislacionit në fuqi. Ajo përshkruan kërkesat për sigurinë kibernetike të rrjetit të energjisë. Me Vendimin nr. 553, datë 15.07.2020, KM ka përcaktuar operatorët e infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit, duke përfshirë edhe listën e infrastrukturave kritike në sektorin e energjisë. Ky vendim përfshin gjenerimin publik Koorporatën Elektroenergjitike Shqiptare (KESH), Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OST) dhe Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) në listën e operatorëve me infrastrukturë kritike.
- Pas miratimit të rregullores për sigurinë kibernetike, janë realizuar ndryshime në legjislacionin rregullator që shërbeu si bazë për miratimin e saj. VKM nr. 761, datë 12.12.2022, ka sjellë shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 553, datë 15.7.2020, duke përditësuar listat e infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit. Brenda këtyre listave janë përfshirë operatorë të rinj që operojnë në sektorin e energjisë elektrike, si

dhe janë miratuar infrastrukturat e rëndësishme të informacionit për një numër operatorësh ekzistues. Këto ndryshime synojnë të forcojnë masat për sigurinë kibernetike dhe mbrojtjen e infrastrukturave kritike në këtë sektor.

- Rregullorja e miratuar nga ERE përfshin në objektin e saj të rregullimit operatorët në sektorin e energjisë elektrike, të identifikuar si të tillë në VKM nr. 553, datë 15.7.2020. Duke marrë parasysh ndryshimet e ndodhura në legjislacion që nga koha e miratimit të rregullores nga ERE, lind nevoja për të bërë disa shtesa dhe përmirësime në këtë rregullore.
- Në “Rregulloren për Sigurinë Kibernetike të Infrastrukturave Kritike në Sektorin e Energjisë Elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 126, datë 30.07.2020, propozohet të bëhen ndryshimet si vijon:
 - Enti Rregullator i Energjisë (ERE) ka ndër objektivat e përcaktuara në nenin 18 të ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, promovimin dhe krijimin e një tregu të brendshëm konkurrues, të sigurt dhe miqësor ndaj mjedisit për të gjithë klientët dhe furnizuesit. Gjithashtu, ERE siguron kushtet e duhura për funksionimin e sigurt dhe të qëndrueshëm të rrjeteve të energjisë elektrike, duke bashkëpunuar ngushtë me Komunitetin e Energjisë dhe autoritetet rregullatore të vendeve të tjera.

ERE është gjithashtu autoriteti përgjegjës për rregullimin në sektorin e gazit natyror, bazuar në ligjin nr. 102/2015. Në përputhje me këtë ligj, objektivat e ERE-s në ushtrimin e funksioneve rregullatore janë: a) Promovimi i krijimit të një tregu të brendshëm konkurrues, të sigurt dhe miqësor ndaj mjedisit për të gjithë klientët dhe furnizuesit. Sigurimi i kushteve të duhura për funksionimin e sigurt dhe të qëndrueshëm të rrjeteve të gazit natyror, në bashkëpunim të ngushtë me Komunitetin e Energjisë dhe autoritetet rregullatore të vendeve të tjera.

Bazuar në sa më sipër, ERE e konsideron sigurinë kibernetike në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror si një element themelor për ruajtjen e sigurisë dhe integritetit të sistemit energjetik dhe të infrastrukturës në sektorin e gazit natyror.

- Kudo në Rregullore, në nenet 2, 3, 5 (paragrafi 1, gërma b), si dhe në nenet 6, 6/1, 7, 8, dhe 10, pas togfjalëshit **energji elektrike / sistem elektroenergjetik / energjetik** shtohet fraza **dhe gazit natyror**.
- Kudo në Rregullore, referenca për ligjin nr. 2/2017 “Për Sigurinë Kibernetike” zëvendësohet me **Ligjin nr. 25/2024 “Për Sigurinë Kibernetike”**.

Ky ndryshim synon të sigurojë përputhshmërinë e akteve rregullatore të ERE-së me dispozitat e VKM nr. 761/2022, duke zgjeruar rregullimin e ERE-s për të përfshirë sektorin e gazit natyror dhe disa subjekte të licencuara në sektorin e energjisë elektrike, të cilët nuk ishin pjesë e listës së infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit në kohën e miratimit të rregullores nga ERE. Përveç kësaj, rregullorja përshtatet dhe përditësohet në përputhje me ligjin e ri nr. 25/2024 “Për Sigurinë Kibernetike”, të miratuar nga Kuvendi, duke siguruar një qasje të përditësuar dhe gjithëpërfshirëse për mbrojtjen e sigurisë kibernetike në sektorët e energjisë elektrike dhe të gazit natyror.
- Në nenin 4, bëhen ndryshime në pikën 6, ku shtohen subjektet: Kurum International sh.a. - Sistemi SCADA, Dragobia Energy - Sistemi SCADA, Prell Energy sh.p.k. - Sistemi SCADA, Power Elektrik Slabinje - Sistemi SCADA, Seka Hydropower - Sistemi

SCADA, Devoll Hydropower sh.a. - Servera, switche, firewall, dhe Trans Adriatic Pipeline (TAP) - Sistemi SCADA.

Ky ndryshim ka për qëllim të sigurojë përputhshmërinë e akteve rregullatore të ERE-s me dispozitat e VKM nr. 761/2022, ashtu siç janë përcaktuar në Shtojcën 1 të këtij vendimi. Përfshirja e këtyre subjekteve garanton adresimin e infrastrukturave kritike në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregullatore.

- **Pas pikës 6 të nenit 4 shtohet pika 6/1 me përmbajtjen si vijon:** “Infrastrukturat e rëndësishme të informacionit janë persona juridikë, publikë ose privatë, që administrojnë infrastrukturën e rëndësishme të informacionit dhe operojnë në sektorin e energjisë elektrike. Këto përfshijnë: Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) me Data Center Primary, Data Center Disaster Recovery, Data Center Business Continuity, rrjetin midis Data Center PR, DR dhe BC, si dhe rrjetin midis qendrës së të dhënave dhe pikave të komandimit; Termocentralin Vlorë sh.a me Sistemin DCS; dhe HEC Vlushë me Sistemin SCADA.”

Këto ndryshime sigurojnë harmonizimin e rregullores me përcaktimet e VKM nr. 761/2022 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin Nr. 553, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave", sikurse janë specifikuar në Shtojcën 2 të këtij vendimi.

- **Neni 5, pika 1, paragrafi i parë ndryshon dhe bëhet si vijon:** Rregullorja për sigurinë kibernetike në infrastrukturat kritike dhe ato të rëndësishme në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror është hartuar bazuar në nenin 18 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, në nenin 15 të Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, në Ligjin nr. 25/2024 “Për Sigurinë Kibernetike” dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 553, datë 15.07.2020, “Për miratimin e Listës së Infrastrukturave Kritike të Informacionit dhe të Listës së Infrastrukturave të Rëndësishme të Informacionit”, të ndryshuar.
- **Në nenin 6,** titulli ndryshon dhe bëhet: **“Detyrimet e Operatorëve të Infrastrukturave Kritike dhe të Infrastrukturave të Rëndësishme të Informacionit.”**
- **Neni 6/1:** Kudo ku referohet **Operatorët e Infrastrukturave Kritike**, termi ndryshon dhe bëhet **Operatorët e Infrastrukturave Kritike dhe të Infrastrukturave të Rëndësishme të Informacionit.**
- **Neni 9 ndryshon dhe bëhet:** Në rast se i licencuari nuk vepron në përputhje me planin e masave, ndaj tij zbatohen sanksione sipas nenit 107 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, nenit 106 të Ligjit Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, si dhe “Rregullores për procedurat e vendosjes dhe reduktimit të gjobave”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE.
- *Në këtë rast, duke pasur parasysh se në fushën e rregullimit përfshihen edhe infrastrukturat e gazit natyror, si dhe disa të licencuar të tjerë që operojnë në sektorin e energjisë elektrike, baza ligjore duhet të referojë jo vetëm ligjin rregullues për sektorin e energjisë elektrike, por edhe atë për sektorin e gazit natyror. Kjo siguron harmonizimin dhe përputhshmërinë e rregullores me kuadrin ligjor përkatës për të dy sektorët.*
- **Neni 10 ndryshon dhe shtohen paragrafët 2 dhe 3 si vijon:**
10.2 Operatorët e Infrastrukturave Kritike të Informacionit, përfshirë Kurum International sh.a, Dragobia Energy, Prell Energy sh.p.k, Power Elektrik Slabinje, Seka Hydropower, Devoll Hydropower sh.a dhe Trans Adriatic Pipeline (TAP), detyrohen të pajisen me certifikimin sipas standardit të sigurisë ISO 27001 brenda 18 muajve nga hyrja në fuqi e këtyre ndryshimeve të rregullores.

10.3 Operatorët e Infrastrukturave të Rëndësishme të Informacionit, përfshirë Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, Termocentralin Vlorë sh.a dhe HEC Vlushë, detyrohen të pajisen me certifikimin sipas standardit të sigurisë ISO 27001 brenda 18 muajve nga hyrja në fuqi e këtyre ndryshimeve të rregullores.

Në këtë rast, kur në fushën e rregullimit shtohen infrastruktura të reja që nuk kanë qenë më parë pjesë e strukturave kritike ose të rëndësishme të informacionit, të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave, me përfshirjen e tyre në listat përkatëse të infrastrukturave kritike dhe atyre të rëndësishme të informacionit, ato, ashtu si dhe strukturat e identifikuar më herët në këtë rregullore, janë të detyruara të pajisen me certifikatat përkatëse që garantojnë përputhshmërinë me standardet e sigurisë.

- Ndryshimet e propozuara adresojnë një nga rekomandimet e parashikuara në Rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë “Për vlerësimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë për vitin 2023”. Në këtë Rezolutë, ERE-s i është lënë detyrë të rishikojë rregullat për infrastrukturat kritike në sektorin e energjisë.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Fillimin e procedurës për disa ndryshime në “Rregulloren për sigurinë kibernetike të Infrastrukturave Kritike në Sektorin e Energjisë Elektrike”.
2. Kudo në Rregullore propozohet të ndryshojnë nenet 2, 3, 5 (paragrafi 1, gërma b), nenet 6, 6/1, 7, 8, 9 dhe 10 (ndryshimet e propozuara bashkëlidhur këtij vendimi).
3. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI

PROPOZIMET PËR NDRYSHIME NË RREGULLOREN PËR SIGURINË KIBERNETIKE TË INFRASTRUKTURAVE KRITIKE NË SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE

<p><i>Propozohet të ndryshojë</i></p>	<p>Neni 1</p>	<p>Enti Rregullator i Energjisë ka ndër objektivat e përcaktuara në nenin 18 të ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, promovimin dhe krijimin e një tregu të brendshëm konkurrues të sigurt dhe miqësor ndaj mjedisit për të gjithë klientët dhe furnizuesit, duke siguruar kushtet e duhura për funksionimin e sigurt dhe të qëndrueshëm të rrjeteve të energjisë elektrike, në bashkëpunim të ngushtë me Komunitetin e Energjisë dhe autoritetet rregullatore të vendeve të tjera.</p> <p>ERE është gjithashtu autoriteti përgjegjës për rregullimin në sektorin e gazit natyror, bazuar në ligjin nr. 102/2015. Në përputhje me këtë ligj, objektivat e ERE-s në ushtrimin e funksioneve rregullatore janë: a) Promovimi i krijimit të një tregu të brendshëm konkurrues, të sigurt dhe miqësor ndaj mjedisit për të gjithë klientët dhe furnizuesit. Sigurimi i kushteve të duhura për funksionimin e sigurt dhe të qëndrueshëm të rrjeteve të gazit natyror, në bashkëpunim të ngushtë me Komunitetin e Energjisë dhe autoritetet rregullatore të vendeve të tjera.</p> <p>Bazuar në sa më sipër ERE konsideron sigurinë kibernetike në sektorin e energjisë elektrike si element themelor për ruajtjen e sigurisë dhe integritetit të sistemit elektroenergjetik Shqiptar.</p>
<p><i>Propozohet të ndryshojë</i></p>	<p>në Nenet 2, 3, 5 (paragrafi 1, gërma b), si dhe në Nenet 6, 6/1, 7, 8, dhe 10</p>	<p>pas togfjalëshit energji elektrike / sistem elektroenergjetik / energjetik propozohet të shtohet fraza dhe gazit natyror.</p>
<p><i>Propozohet të ndryshojë</i></p>	<p>në Nenet 4, 5 (paragrafi 1) (paragrafi 1, gërma a), (paragrafi 2), 6 (paragrafi</p>	<p>Kudo në Rregullore, referenca për ligjin nr. 2/2017 “Për Sigurinë Kibernetike” zëvendësohet me Ligjin nr. 25/2024 “Për Sigurinë Kibernetike”.</p>

	1, gërma d), 6/1 (paragrafi 4), 7	
<i>Propozohet të ndryshojë</i>	Në nenet 5 (paragfari 2, gërma a), 6 (paragrafi 1, gërmat a dhe b), shtojca 1	Kudo në Rregullore, referenca AKCESK zëvendësohet me AKSK
<i>Propozohet të ndryshojë</i>	Neni 4, pika 6	“Operator i infrastrukturës kritike të informacionit” - është një person juridik, publik ose privat, që administron infrastrukturën kritike të informacionit dhe operon në sektorin e Energjisë Elektrike OST sh.a., OSHEE sh.a., KESH sh.a., Kurum International sh.a. – Sistemi SCADA, Dragobia Energy– Sistemi SCADA, Prell Energy sh.p.k. – Sistemi SCADA, Power Elektrik Slabinje – Sistemi SCADA, Seka Hydropower – Sistemi SCADA, Devoll Hydropower sh.a. – Servera, switche, firewall, dhe Trans Adriatic Pipeline (TAP) – Sistemi SCADA.
<i>Propozohet të shtohet</i>	Neni 4, pika 6.1	“Infrastrukturat e rëndësishme të informacionit” - janë persona juridikë, publikë ose privatë, që administrojnë infrastrukturën e rëndësishme të informacionit dhe operojnë në sektorin e energjisë elektrike. Këto përfshijnë: Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) me Data Center Primary, Data Center Disaster Recovery, Data Center Business Continuity, rrjetin midis Data Center PR, DR dhe BC, si dhe rrjetin midis qendrës së të dhënave dhe pikave të komandimit; Termocentralin Vlorë sh.a me Sistemin DCS; dhe HEC Vlushë me Sistemin SCADA.”
<i>Propozohet të ndryshojë</i>	Neni 4, pika 11	“AKSK” – është Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike.
<i>Propozohet të ndryshojë</i>	Neni 5, paragrafi 1	Rregullorja për sigurinë kibernetike në infrastrukturat kritike dhe ato të rëndësishme në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror është hartuar bazuar në nenin 18 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, në nenin 15 të Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, në Ligjin nr. 25/2024 “Për Sigurinë Kibernetike” dhe Vendimin e Këshillit të

		Ministrave nr. 553, datë 15.07.2020, "Për miratimin e Listës së Infrastrukturave Kritike të Informacionit dhe të Listës së Infrastrukturave të Rëndësishme të Informacionit", të ndryshuar.
<i>Propozohet të ndryshojë</i>	Neni 6	Detyrimet e Operatorëve të Infrastrukturave Kritike dhe të Infrastrukturave të Rëndësishme të Informacionit
<i>Propozohet të ndryshojë</i>	Neni 6/1	Kudo në Rregullore ku referohet Operatorët e Infrastrukturave Kritike, termi propozohet të ndryshojë Operatorët e Infrastrukturave Kritike dhe të Infrastrukturave të Rëndësishme të Informacionit.
<i>Propozohet të ndryshojë</i>	Neni 9	Në rast se i licencuari nuk vepron në përputhje me planin e masave, ndaj tij zbatohen sanksione në përputhje me nenin 107 të Ligjit 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, nenit 106 të Ligjit Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror” si dhe “Rregulloren për procedurat e vendosjes dhe reduktimit të gjobave” miratuar me vendimin e Bordit të ERE.
<i>Propozohet të ndryshojë</i>	Neni 10	Operatorët e Infrastrukturave Kritike në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror të pajisen me certifikimin me standartin e sigurisë ISO 27001 brenda 18 muajve nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje.
<i>Propozohet të shtohet</i>	Neni 10 paragrafi 2	Operatorët e Infrastrukturave Kritike të Informacionit, përfshirë Kurum International sh.a, Dragobia Energy, Prell Energy sh.p.k, Power Elektrik Slabinje, Seka Hydropower, Devoll Hydropower sh.a dhe Trans Adriatic Pipeline (TAP), detyrohen të pajisen me certifikimin sipas standardit të sigurisë ISO 27001 brenda 18 muajve nga hyrja në fuqi e këtyre ndryshimeve të rregullores.
<i>Propozohet të shtohet</i>	Neni 10 paragrafi 3	Operatorët e Infrastrukturave të Rëndësishme të Informacionit, përfshirë Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, Termocentralin Vlorë sh.a dhe HEC Vlushe, detyrohen të pajisen me certifikimin sipas standardit të sigurisë ISO 27001 brenda 18 muajve nga hyrja në fuqi e këtyre ndryshimeve të rregullores.